



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN) më datë **26.03.2014**, realizoi vizitë për ri-kontroll në **Spitalin Psikiatrik Demir Hisar** në shoqërimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Shoqatës së Psikiatërve, si dhe Shoqatës së ForezNIKëve të Institutit për Mjekësi Ligjore, në bazë të Memorandumit të nënshkruar paraprak.

Qëllimi i vizitës për ri-kontroll është të bëhet vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve nga raporti i veçantë i MPN-së nga viti 2012, si dhe të identifikohen rreziqet shtesë me qëllim të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Ekipi i MPN-së, zhvilloi bisedë me kompetentët e spitalit, ndërsa më pas duke u ndarë në dy nën-ekipe bëri këqyrje në repartin akut, repartin për gjendje kronike, repartin e kombinuar ose adoleshent, repartin gjyqësor, repartin për alkoolizëm, repartin për psikogeriatri, si dhe në repartin për terapi pune, kuzhinë dhe në magazinën për produkte ushqimore. Gjatë vizitës u realizua këqyrje mbi dosjet mjekësore të reparteve të vizituara, si dhe dokumentacionin për fiksime.

Gjatë vizitës për ri-kontroll u paraqit programi për edukimin e personelit me arsim të mesëm për vitin 2014, ndërsa rekomandim i ekipit të MPN-së është të vazhdohet me këtë tendencë, përkatësisht në mënyrë permanente të mbështetet edukimi edhe i personelit me arsim të lartë nga të gjitha profilet, përfshirë edhe psikiatrit, psikologët dhe punonjësit social.

Nga ana e MPN-së u konstatua se në spital është caktuar një dhomë për fiksime të pacientëve dhe në këtë ambient ka më shumë krevate, nga të cilët dy janë të fiksuara për dysheme. Gjatë kohës së fiksimit mbikëqyrje bën sanitari, ndërsa infermierja kohë pas kohe e viziton pacientin. MPN-ja, realizoi këqyrje në disa histori të pacientëve, të cilët janë fiksuar me detyrim, si dhe zhvilloi bisedë me pacientë të cilët kanë qenë të fiksuar. U konstatua se respektohen të gjitha procedurat e fiksimit, dokumentacioni plotësohet me rregull, si dhe ndiqet gjendja shëndetësore.

Gjatë kohës së vizitës në Spitalin Psikiatrik Demir Hisar, në pavijonet akute dhe kronike, MPN-ja nuk pranoi ankesa sa i përket sjelljes së personelit mjekësor, përkatësisht sa i përket mënyrës së ofrimit të kujdesit ndaj shëndetit të tyre dhe komunikimit të përditshëm. Nga pacientët, MPN-ja nuk pranoi ankesa për përdorimin e tepërt të forcës nga ana e personelit mjekësor gjatë kohës së hospitalizimit të tyre. Gjatë zbatimit të këqyrjes së reparteve të Spitalit Psikiatrik u zhvillua bisedë me një pjesë të pacientëve. Nga bisedat e zhvilluara me pacientët u njoftua se, në masë të madhe, ata janë të kënaqur nga mënyra me të cilën personeli mjekësor u ofron kujdes. Vizitat realizohen për çdo ditë dhe pacientët janë në kontakt të përditshëm, si me mjekët ashtu edhe me personelin tjetër mjekësor.

Kërkesat e pacientëve në lidhje me kontrollet mjekësore dhe higjienën, personeli mjekësor përpiqet t'i plotësojë në kuadër të mundësive ekzistuese.

Ankesat kanë të bëjnë me regjimin e përforcuar në repartin gjyqësor, veçanërisht për nevojën e marrjes së lejes nga gjykata kompetente për shfrytëzimin e vikendit terapeutik.

Tek një pjesë e madhe e pacientëve u konstatua gjendje e keqe e dhëmbëve, e cila do të duhej të ishte në nivel më të lartë duke marrë parasysh se në përbërje të spitalit psikiatrik ka ordinancë stomatologjike.

Në disa reparte, siç është reparti kronik i meshkujve u fitua përshtypja se larja bëhet në grup, gjë që nuk do të duhej të ishte kështu, përkatësisht larja duhet të jetë individuale. Në repartet geriatrike (për meshkuj dhe për femra), duke pasur parasysh gjendjen e tyre shëndetësore, ku pjesa më e madhe e pacientëve nuk mund të kujdesen për vetvete, pacientët duhet të lahen nga disa herë në javë.

Reparti për adoleshentë është i ndarë në pjesën për meshkuj dhe pjesën për femra, por një paciente u ankua se pasdite dhe në mbrëmje nuk i lënë rehat pacientët meshkuj, në kohën kur dyert janë të hapura. Në këtë drejtim nevojitet kontroll më i rreptë dhe të mos lejohet hyrja e pacientëve meshkuj në dhomat e pacienteve femra dhe anasjelltas.

Gjatë vizitës për ri-kontroll, MPN-ja u informua se Spitali Psikiatrik Demir Hisar është përfshirë në planin për renovim të Ministrisë së Shëndetësisë – edhe atë në fazën e dytë, që pritet të fillojë gjatë këtij viti.

Në lidhje me kushtet dhe gjendjen e reparteve, u konstatua se një pjesë e reparteve janë rinovuar, para së gjithash nyjat sanitare në repartin për alkoolizëm, repartin akut – për femra, repartin kronik – për femra dhe repartin geriatrik për femra. Por sa i përket inventarit, në përgjithësi në të gjitha repartet vërehet amortizimi i dyshekëve, krevateve dhe mungesa e shtrojës, si dhe mungesa e dollapëve për nevoja personale. Reparti gjyqësor akoma është i vendosur në ambiente joadekuate, ndërkohë që nuk ka as repart për femra.

MPN-ja, gjatë vizitës për ri-kontroll, u informua se për higjienën e spitalit është angazhuar një Agjenci për pastrim dhe se spitali në mënyrë shtesë siguron mjete për pastrim. Megjithatë, gjatë kontrollit u konstatua se higjiena nuk mirëmbahet në nivel kualitativ, ndërkaq sidomos ndihej kundërmim i fortë i pakëndshëm në repartin kronik të meshkujve, si dhe në pavijonet e psikogeriatrisë.